REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR—**1061**—REP

NR—**527**—KOL

REPUBLIKA E SHQIPERISE SOKOL SH. MALAJ NOTER TIRANË

Taksa e pullës u pagua

# KONTRATË SHIT-BLERJE E KUOTAVE TË KAPITALIT

***në bazë të Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"***

Sot më datë 01 Qershor 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) ditën e premte para meje Noterit **Sokol Sh. MALAJ**, Noter në dhomën e Noterisë Tiranë me seli në Rr."L.Gurakuqi" u paraqitën personalisht:—

**PALA SHITËSE:**

**Z. FATMIR SAKOLLI** i biri i Jonuzit dhe Behare lindur në Berat më 30.09.1970, banues në Tiranë Rr."Faik Konica", P.Firma Enri, Nr.7, identifikuar me Pasaportën BF2569226 me Nr personal #H00930114W, aktualisht përdorues i telefonit Nr 00355693893288.—

**Z. RAIMONDO MALAJ** i biri i Kodhel dhe Resmie lindur në Fier, më 30.05.1968 banues në Tiranë, Rr"Budi", Pall "Klasik Konstruksion", Shk 1, Ap 14, i pajisur me Kartën e Identitetit #030051391# me Nr personal #G80531045D#.—

**PALA BLERËSE:**

**Z. LUCA PARAZZA** i biri i Antonio dhe Alfonsa, lindur në Bologna më 10.05.1975 banues në Bologna, Via Cesare, Boldrini, 5/2, i identifikuar me Pasaportën italiane YA0897876, i cili deklaron se nuk e kupton gjuhën shqipe dhe asistohet prej meje Noterit në gjuhën Italiane.—

**Z. ARTID HYKA** i biri i Kodhel dhe Resmie lindur në Fier, më 16.09.1975, banues në Tiranë, Rr."Todi Shkurti", Njësia Bashkiake Nr 2, i pajisur me Kartën e Identitetit #028592301# me Nr personal #H50916130K#, aktualisht përdorues i telefonit Nr 00355695151510.—

Të lartpërmendurit janë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët pasi u sqaruan për pasojat juridike që sjell ky akt noterial, deklaruan se lidhin Kontratën e shitblerjes të kuotave të kapitalit me kushtet si vijon:—

Pala shitëse, me vullnetin e saj të lirë e të plotë deklaron se është pronar i ligjshëm në pjesët e kapitalit që përcaktohen në ekstraktin e QKB në shoqërinë "HYPAR GROUP" shpk, regjistuar pranë QKB (ish QKR) më datë 28.03.2018 me Nr unik të identifikimit të subjektit NIPT- **L81528022A**, e

cila ndodhet me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr 2, Rr"Luigj Gurakuqi", Pallati 2/2, Kati 1, dhe me Administrator **Z. RAIMONDO MALAJ**, respektivisht:

- **Z. FATMIR SAKOLLI** ka në pronësi kuotën prej 50,00% të kapitalit.—
- **Z. RAIMONDO MALAJ** ka në pronësi kuotën prej 50,00% të kapitalit.—

Nisur nga interesat e tyre dhe në bazë të Vendimit të asamblesë së ortakëve me Nr 1 datë 01.06.2018 **vërtetuar kjo me Vërtetimin Noterial me Nr.1058REP të datës 01.06.2018, i hartuar/ noterizuar nga Noter Sokol Sh. MALAJ**, Shitësit janë dakort që nga pjesët e tyre që ata kanë në këtë shoqëri, pra 70,00% të pjesëve mbi kapitalin e kësaj shoqërie, t´ja shesin blerësve **Z. LUCA PARAZZA do t'i kalojë 50% e kuotës së kapitalit** dhe **Z. ARTID HYKA do t'i kalojë në pronësi 20% e kuotës së kapitalit.—**

Çmimi i shitjes në bazë të marrëveshjes së arritur nga palët jashtë kësaj Zyre, është caktuar në vlerën prej **70.000 ALL(shtatëdhjetë mijë lekë)**, për pjesët, ku kuota prej 50% e kapitalit është në vlerën 50.000 ALL (pesëdhjetë mijë lekë) dhe kuota prej 20% e kapitalit është në vlerën prej 20.000 ALL (njëzet mijë Lekë).—

Pala shitëse deklaron se kjo shumë i është likuiduar plotësisht jashtë kësaj zyre nga pala Blerëse, me para në dorë (CASH).—

Edhe Blerësit **Z. LUCA PARAZZA** dhe **Z. ARTID HYKA** deklarojnë se pranojnë të blejnë pjesët me kuotat kapitalit në shoqërinë e mësipërme në çmimin që ata kanë caktuar në marrëveshje të përbashkët, shumë kjo që i është likujduar plotësisht shitësve jashtë kësaj zyre me pra në dorë (cash).—

Kështu:

- shitësit **Z. FATMIR SAKOLLI** i është likujduar nga blerësi i kuotës së tij Z. LUCA PARAZZA vlera prej 50.000 lekë (pesëdhjetë mijë) për kuotën prej 50% të kapitalit, dhe
- shitësit **Z. RAIMONDO MALAJ** i është likujduar nga blerësi i kuotës së tij **Z. ARTID HYKA** vlera prej 20.000 lekë (njëzet mijë) për kuotën prej 20% të kapitalit.—

Me likuidimin e plotë të vlerës së shitjes, pra të çmimit prej **70.000 lekë (shtatëdhjetë mijë)**, shitësit e humbasin pjesërisht të drejtën e pronësisë në pjesët /kuotat respektive, ndërsa Blerësit **Z.LUCA PARAZZA** dhe **Z. ARTID HYKA** fitojnë pronësinë në kuotat përkatësisht:

- **Z. LUCA PARAZZA** bëhet ortak në kuotën prej 50% të kapitalit.—
- **Z. ARTID HYKA** bëhet ortak në kuotën prej 20% të kapitalit.—
- **Z. RAIMOND MALAJ** ruan kuotën prej 30% të kapitalit.—

Administratorë të shoqërisë **“HYPAR GROUP“ SH.P.K, për një periudhë 5(pesë) vjeçare, nga data e regjistrimit në QKB do të jenë Z. RAIMONDO MALAJ dhe Z. LUCA PARAZZA,** Administratorë të shoqërisë **“HYPAR GROUP“ SH.P.K, të cilët kanë të drejtë të administrojnë shoqërinë bashkarisht ose të pavarur.—**

Pra, me hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Noterial, shitësit **Z. FATMIR SAKOLLI e humbet të drejtën e pronësisë mbi kuotën prej 50% të kapitalit** dhe **Z.RAIMONDO MALAJ** e humbet të drejtën e pronësisë në kuotën 20% dhe duke mbetur Ortak në kuotën 30% dhe Ortakë të kësaj Shoqërie, me kuotën prej 50% të kapitalit bëhet blerësi **Z. LUCA PARAZZA** dhe me kuotën prej 20% të kapitalit bëhet Blerësi **Z. ARTID HYKA**.—

Blerësit janë të detyruar të paraqesin pranë **Q. K. B**. Vendimin e Ortakëve dhe aktin noterial të shitjes se kuotave në favor të ortakëve **Z. LUCA PARAZZA** dhe **Z. ARTID HYKA.**—

Për të vërtetuar sa më sipër, u hartua prej meje Noterit kjo kontrate Shit-Blereje e kuotave të kapitalit e cila pasi u lexua nga palët dhe u gjet sipas vullnetit të palëve , u nënshkrua në praninë time sipas ligjit dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—

**PALA SHITËSE:**

**Z. FATMIR SAKOLLI** — **Z. RAIMONDO MALAJ**

Fatmir Sakolli — Raimondo Malaj

**PALA BLERËSE:**

**Z. LUCA PARAZZA** — **Z. ARTID HYKA**

LUCA PARAZZA — Artid Hyka

**N O T E R I**

**S O K O L SH. M A L A J**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SOKOL SH. MALAJ NOTER TIRANË

NOTER. SOKOL SH. MALAJ
RR. "LUIGJ GURAKUQI" P 2 TIRANË, ALBANIA
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4
e-mail: kolimalaj@hotmail.de